



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”

ofruar nga

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha
Dr. Fatmir Basholli**

Janar 2024

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	<i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 371, Nr. 4438 Prot., datë 05.09.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër MAS Nr. 379, Nr. 4582/1 Prot., datë 08.07.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASR Nr. 345, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë (<i>Bachelor</i>)
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a. 2020 – 2021 – 9/10 v.a. 2021 – 2022 – 9/10 v.a. 2022 – 2023 – 9/9
18	Numri i studentëve:	v.a. 2019 – 2020 – 25 v.a. 2020 – 2021 – 34 v.a. 2021 – 2022 – 25
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë *Bachelor* në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Hapja e programit të studimit të ciklit të parë *Bachelor* në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është miratuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 371, Nr. 4438 Prot., datë 05.09.2013, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit.

Programi i studimit është hartuar dhe përditësohet në vazhdimësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e navigacionit dhe menaxhimit detar. Kurrikula e këtij programi studimi është rishikuar:

- në vitin 2016, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 528, datë 18.07.2013,
- në vitin 2018, brenda masës 20%, në përputhje me aktet e reja ligjore dhe nënligjore. Ndryshimet janë miratuar me shkresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 4753/1 Prot., datë 17.05.2018,
- në vitin 2022, është riorganizuar në masën mbi 20%, mbështetur në kërkesat e Konventës Detare Ndërkombëtare STCW 78 të ndryshuar dhe kurrikulave analoge të vendeve anëtare të BE. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar, miratuar me Urdhërin e MAS Nr. 379, Nr. 4582/1 Prot., datë 08.07.2022, fillon nga viti akademik 2022 – 2023.

Ky program realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të parë *Bachelor* në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2013 – 2014. Në vitin akademik 2019 – 2020, janë regjistruar 25 studentë, në vitin akademik 2020 – 2021, 34 studentë, në vitin akademik 2021 – 2022, 25 studentë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha dhe Dr. Fatmir Basholli, me mbështetjen e koordinatores së ASCAL, MSc. Rajna Lila.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin Janar 2022, me dorëzimin nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me UAMD, në datat 13 dhe 14 Qershor 2023, GVJ vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh dhe intervistash me Dekanin e Fakultetit të Studimeve Profesionale, Përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, të Sektorit të Burimeve Njerëzore, të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe me studentët e programit të studimit. Gjithashtu, GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Bibliotekë, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përputhje me Statutin e tij [Evidencë 19, Neni 3, fq. 1], UAMD ka mision të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane. UAMD realizon misionin e tij përmes zhvillimit të arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente [Evidencë 19, Neni 4, fq. 2].
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e UAMD për të formuar specialistë të lartë dhe përgatitur shkencëtarë të rinj [Evidencë 19, Neni 3, fq. 1].
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit, si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Në përputhje me planin e zhvillimit strategjik të tij, në kuadër të interesit rajonal, UAMD synon, ndër të tjera, trajnimin e specialistëve në sektorin e detarisë [Evidencë 17, fq. 7].
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Gjatë vitit akademik 2021 – 2022, Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), si pjesë e Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP), ka patur në përbërje të tij 14 personel akademik efektiv (PAE): 1 Prof. Asoc. Dr., 4 Dr., 1 Dr. Proc., 8 MSc. dhe 30 personel akademik me kontratë (PAK): 1 Prof. Dr., 4 Dr., 25 MSc. [Evidencë 21, Evidencë 22, Evidencë 23]. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij [Evidencë 24].
	DSID disponon, në funksion të programeve të studimit që ofron, laboratorë bashkëkohore përmes të cilëve, studentët realizojnë orë praktike në përputhje me programin e studimit dhe nevojat për aftësimin praktik të tyre [Evidencë 91, Evidencë 92, Evidencë 38].



<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “<i>Navigacion dhe Menaxhim Detar</i>” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), si pjesë e Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP), në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij. Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), si pjesë e Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP), në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale.</i></p> <p><i>Institucioni disponon infrastrukturën laboratorike dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit <i>Bachelor</i> në “<i>Navigacion dhe Menaxhim Detar</i>” realizohet nga DSID, mbështetur në rregulloren e FSP [Evidencë 26], rregulloren e DSID [Evidencë 27], rregulloren e programit të studimit [Evidencë 28], si dhe të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë, personelit akademik nga fakultete të tjera të UAMD, si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësisë respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre [Evidencë 29].</p> <p>Marrëdhënia midis strukturave të ndryshme brenda UAMD, njësisë të ndryshme administrative dhe akademike rregullohet përmes rregullores së brendshme të Institucionit [Evidencë 20].</p>




<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit UAMD ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase si: Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, Akademia e Forcave të Armatosura, Kolegji Profesional i Tiranës, Kolegji Universitar “Luarasi”, si dhe institucione të huaja të arsimit të lartë si: Universiteti i Malit të Zi, Akademia e Detarisë së Lituaniës etj. [Evidencë 31, Evidencë 56.1, Evidencë 64], të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara.</p>			
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të navigacionit dhe menaxhimit detar, si: Autoriteti Portual Durrës [Evidencë 33], Drejtoria e Përgjithshme Detare [Evidencë 34], kompania Adria Ferries [Evidencë 35] etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>DSID kujdeset për krijimin e mundësive për zhvillimin korrekt të praktikave profesionale për të gjithë studentët e tij, në përputhje me programin e studimit të ofruar [Evidencë 37]. <i>GVJ, nisur nga DVV dhe vizita në Institucion, konstaton që nuk është hartuar një raport analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara. UAMD falë bashkëpunimeve me ente vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre. GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion, konstaton që Institucioni nuk ka hartuar një raport analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





				X
--	--	--	--	---

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë pranë UAMD, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [<u>Evidencë 42</u>, <u>Evidencë 47</u>].</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” ofron studime bazë në shkencat nautike për drejtues dhe administrues të anijeve të transportit të mallrave (anijeve tregtare), të anijeve të peshkimit, turistike, si dhe të pasagjerëve, për plotësimin e kërkesave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe për operimin dhe menaxhimin e mjeteve detare në shërbim të sektorëve të lundrimit detar [<u>Evidencë 28</u>, <u>Neni 7</u>, fq. 5].</p> <p>Objektivat kryesore formuese të këtij programi janë [<u>Evidencë 28</u>, <u>Neni 6</u>, fq. 4-5]:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor për të drejtuar dhe administruar anijet e transportit të mallrave (anijeve tregtare), anijet e peshkimit, turistike dhe të anijeve për pasagjerë, b. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor për navigimin e anijes dhe stabilitetin e saj, në njohjen e të gjitha taktikave drejtuese të anijes, njohjen e teknikave lundrimore, lundrimit elektronik, për drejtimin e sigurtë të anijeve të tipeve dhe tonazheve të ndryshëm, për emergjencat e anijes gjatë lundrimit dhe përgatitja për të përballuar mbijetesën në det, c. Përgatitja e specialistëve të kualifikuar në njohjen e konstruksioneve të anijeve, të mekanizmave, të motorëve dhe agregateve, si dhe të sistemeve të komandimit të anijeve, të aparaturave elektronike të navigimit dhe të komunikimit, d. Përgatitja e specialistëve të kualifikuar për trajtimin e ngarkesave dhe në veçanti të ngarkesave të rrezikshme në anije, për proceset e ngarkim-shkarkimit në anije, për menaxhimin e anijes dhe të operacioneve portuale, si dhe të menaxhimit të




	<p>transportit detar, në sektorin publik dhe privat që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e detarisë në përgjithësi, për të analizuar dhe vlerësuar situata të ndryshme teknike të menaxhimit,</p> <p>e. Përgatitja e specialistëve për vlerësimin e problematikave të sigurisë navigacionale në anije dhe në port dhe kërcënimeve të tjera që janë prezent në fushën e detarisë, si dhe hartimi i strategjive përkatëse në përballjen me kërcënime të tilla.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [Evidencë 42]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë (A) – 28 ECTS – 15.56 %, - Lëndë karakterizuese (B) – 98 ECTS – 54.44%, - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 22 ECTS – 12.22 %, - Lëndë plotësuese (D) – 24 ECTS – 13.33 %, - Detyrime përmbyllëse (E) – 8 ECTS – 4.44 %.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Si pjesë e lëndëve plotësuese (D) janë parashikuar dy module për Praktikën profesionale detare, gjithsej 14 ECTS. Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 8 ECTS [Evidencë 42].</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimiti i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UAMD ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve [Evidencë 20, Neni 44, fq. 24; Evidencë 28, Neni 22-24, fq. 14-18; Evidencë 119] bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>UAMD nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtesë. Nga informacionet që GVJ disponon, një program i ngjashëm ofrohet nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, me emërtimin <i>Bachelor</i> në “Navigacion”.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet</p>	<p>Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces.</p>

kodifikimi i lëndëve të programit.				
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “ <i>Navigacion dhe Menaxhim Detar</i> ” nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë. Institucioni është i angazhuar në realizimin e një programi të përbashkët me Fakultetin e Detarisë Rijeka.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e navigacionit dhe menaxhimit detar. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). UAMD ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike	Fakulteti i Studimeve Profesionale përbëhet nga 4 Departamente si mëposhtë [Evidencë 21]:								
	Nr.	Njësitë bazë të FSP	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Tot.
			Gjithsej	Tituj / Grada	Gjithsej	Tituj / Grada	Gjithsej	Tituj / Grada	
	1	Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë - DSID	14	5	30	5	2	0	46
	2	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore – DSHTM	14	8	48	16	2	0	64

vlerësimin dhe akreditimin.	3	Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës – DSHAN	10	8	4	1	1	0	15
	4	Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën – DESTIP	4	2	35	15	0	0	39
	Në total		42	23	117	37	5	0	164

Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), si pjesë e Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP), përgjegjëse për programin e studimit *Bachelor* në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, ka në përbërje të tij 14 personel akademik efektiv (PAE): 1 Prof. Asoc. Dr., 4 Dr., 1 Dr. Proc., 8 MSc. dhe 30 personel akademik me kontratë (PAK): 1 Prof. Dr., 4 Dr., 25 MSc. [Evidencë 21, Evidencë 22, Evidencë 23].

Kriteri 2.
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Në programin e studimit *Bachelor* në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, gjatë vitit akademik 2020 – 2021 [Tabela 4] janë angazhur në mësimdhënie 9 PAE (3 Prof. Asoc. Dr., 1 Dr., 5 MSc.), 10 PAK (1 Prof. Dr., 1 Dr., 8 MSc.), gjatë vitit akademik 2021 – 2022, janë angazhuar 9 PAE (3 Prof. Asoc. Dr., 1 Dr., 5 MSc.), 10 PAK (1 Prof. Dr., 1 Dr., 8 MSc.), gjatë vitit akademik 2022 – 2023, janë angazhuar 9 PAE (2 Prof. Asoc. Dr., 1 Dr., 6 MSc.), 9 PAK (1 Prof. Dr., 1 Dr., 7 MSc.).

Gjithashtu, pranë DSID janë angazhuar edhe 2 personel administrativ me karakter mësimor [Evidencë 21].

Kualifikimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik me karakter mësimor të angazhuar në këtë program studimi, është në përputhje me specifikat e tij, për realizimin korrekt të praktikave mësimore dhe laboratoreve [Evidencë 24; Evidencë 45].

Kriteri 3.
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për

Koordinator për programin e studimit *Bachelor* në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është MSc. Capt. Shpëtim Pupa [Evidencë 46]. Koordinator i programit zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 28, Neni 12, fq. 7–8].

programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.			
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), si pjesë e Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP), zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe standardet e cilësisë në Arsimin e Lartë, të reflektuara edhe në aktet rregullatore të Institucionit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (DSID), pranë Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP) – UAMD. DSID disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me Statutin [Evidencë 19] dhe rregulloren e Universitetit [Evidencë 20], rregulloren e fakultetit [Evidencë 26] dhe të departamentit [Evidencë 27].
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të	Në planin mësimor [Evidencë 47] të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, si dhe në syllabuset e lëndëve [Syllabuse] jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Frekuentimi/ndjekja e programit përcaktohet në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 28, Neni 45, fq. 33-35], si dhe risillen brenda syllabusit të çdo lënde [Syllabuse]:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

- *Studenti që mungon në 25% të orëve të lëndës vlerësohet automatikisht me notën 4 dhe duhet të ndjekë përsëri lëndën gjatë vitit të ardhshëm.*
- *Të njëjtës masë ndëshkimore do t'i nënshtrohen edhe studentët që kopjojnë në provim ose që kryejnë plagjaturë duke përvetësuar punën akademike të kolegëve ose të autorëve të ndryshëm të disiplinës në fjalë.*
- *Korrupsioni aktiv dhe pasiv është i ndaluar dhe ndaj tyre merren masa ekstreme.*

Në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes [Syllabuse]:

- *provimi i parë (400 pikë të mundshme),*
- *detyrat e kursit (100 pikë të mundshme),*
- *provimi përfundimtar (500 pikë të mundshme).*

Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:

Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Përqindja	Pikët
A (Shkëlqyeshëm- performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)	10	94-100%	935-1000
B (Shumë mirë-në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)	9	85-93%	845-934
C+ (Mirë-mbi standartin mesatar por me disa gabime)	8	76-84%	755-844
C (Mesatar-në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)	7	67-75%	665-754
D (I kënaqshëm-i drejtë por me mangësi të dukshme)	6	58-66%	575-664
E (Mjaftueshëm- performanca u përmbahet kriterëve minimale)	5	51-57%	505-574
FX (Ngel-kërko het më shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)	4	≤50%	0-504

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe

Në rregulloren e programit të studimit jepen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve [Evidencë 28, Neni 22-24, fq. 14-18, Neni 26, fq. 19]:

- I. Pranimi në programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në "Navigacion dhe Menaxhim Detar" është i mundur për*

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43 123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM.</p> <p>2. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë përcakton kriteret e pranimit për programin e studimit Bachelor në "Navigacion dhe Menaxhim Detar", si dhe kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteret e përcaktuara miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatin Akademik, u vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e detajuara të çdo lënde [Syllabuse], hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në "Navigacion dhe Menaxhim Detar", risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit.</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar dhe përditësohet në vazhdimësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e navigacionit dhe menaxhimit detar. Kurrikula e këtij programi studimi është rishikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në vitin 2016, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 528, datë 18.07.2013 [Evidencë 4], - në vitin 2018, brenda masës 20%, në përputhje me aktet e reja ligjore dhe nënligjore. Ndryshimet janë miratuar me shkresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 4753/1 Prot., datë 17.05.2018 [Evidencë 6], - në vitin 2022, është riorganizuar në masën mbi 20%, mbështetur në kërkesat e Konventës Detare Ndërkombëtare STCW 78 të ndryshuar dhe kurrikulave analoge të vendeve anëtare të BE. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar, miratuar me Urdhërin e MAS Nr. 379, Nr. 4582/1 Prot., datë 08.07.2022, fillon nga viti akademik 2022 – 2023 [Evidencë 9].
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Navigacion dhe Menaxhim Detar" përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Instucioni kujdeset në përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve në përputhje me nevojat e tregut, ndryshimet më të fundit teknologjike dhe literaturën bashkëkohore.</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 42, Evidencë 47]. Viti akademik është i organizuar në semestra. Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [Evidencë 42]:
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	<ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë (A) – 28 ECTS – 15.56 %, - Lëndë karakterizuese (B) – 98 ECTS – 54.44%, - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 22 ECTS – 12.22 %, - Lëndë plotësuese (D) – 24 ECTS – 13.33 %, - Detyrime përmbyllëse (E) – 8 ECTS – 4.44 %. Si pjesë e lëndëve plotësuese (D) janë parashikuar dy module për Praktikën profesionale detare, gjithsej 14 ECTS. Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 8 ECTS [Evidencë 42].
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare [Evidencë 56], në përputhje me formimin e kërkuar në tregun e punës në këtë profil brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar punësimin e shpejtë të studentëve brenda profilit të studimit. Riorganizimi i fundit, në vitin 2022, i programit të studimit në masën mbi 20%, është bërë mbështetur në kërkesat e Konventës Detare Ndërkombëtare STCW 78 të ndryshuar dhe kurrikulave analoge të vendeve anëtare të BE [Evidencë 9].
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në	DSID kujdeset në përditësimin e syllabuseve të lëndëve [Evidencë 96] në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe literaturën bashkëkohore në fushën e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve [Evidencë 52, Evidencë 53].			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “ <i>Navigacion dhe Menaxhim Detar</i> ” u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave, për t’u punësuar në fushën e navigacionit dhe menaxhimit detar, vendas dhe të huaj, në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë <i>Master Profesional</i> dhe <i>Master i Shkencave</i> në përputhje me profilin e studimit.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit i përgatit të diplomuarit, në përputhje me nevojat e tregut të punës, brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar punësimin e shpejtë të tyre në përputhje me profilin e studimit.			
Konkluzione	<i>Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës dhe literaturën bashkëkohore, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të	Riorganizimi, në vitin 2022, i programit të studimit në masën mbi 20% [Evidencë 9], është mbështetur në diskutimet me institucionet partnere dhe bizneset, të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e detarisë [Evidencë 56.1, Evidencë 57].

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.				
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 58], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 140].			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në vitin 2022, Institucioni ka riorganizuar programin e studimit <i>Bachelor</i> në “ <i>Navigacion dhe Menaxhim Detar</i> ” në masën mbi 20% [Evidencë 9], mbështetur në propozimet dhe zhvillimet e fundit të propozuara nga profesionistë, të cilët zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e detarisë [Evidencë 56.1, Evidencë 57].			
Konkluzione	<i>Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Ngarkesa në auditor e studentëve [Tabela 13] është e organizuar në leksione (570 orë), seminare/ushtrime (321 orë), laboratorë (28 orë), forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (146 orë), praktikë profesionale (180 orë) dhe udhëheqje teze diplome/konsultime për provimin përfundimtar të formimit (10 orë), gjithsej 1255 orë.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Mësimdhënia në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është kombinim i njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale [Evidencë 47], e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional. Personeli akademik ka vëmendje të veçantë në përshtatjen e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e studentëve. DSID parashikon gjatë gjithë vitit akademik konsulta të vazhduara të pedagogëve me studentët për plotësimin e nevojave të tyre [Evidencë 62].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	NjSBC, dhe në mënyrë të veçantë DSID, mbështetin personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të DSID. Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) [Evidencë 64, Evidencë 65] i kanë shërbyer përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit tek studenti mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e	Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është i angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës në universitete dhe në Institucione të tjera të profilit, duke sjellë eksperiencën e tyre si mësimdhënës në UAMD [Evidencë 24]. Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>DSID kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 58], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 140].</p>		
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>Në UAMD funksionon Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila është e përbërë nga dy sektorë: Sektori i Çështjeve Mësimore dhe Sektori i Kurrikulës dhe Vlerësimit të Cilësisë [Evidencë 141, Evidencë 70]. Këto struktura promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike [Evidencë 69].</p> <p>DSID monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Format e kontrollit të dijeve në DSID janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar, me kontroll dhe vëzhgim. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe të Praktikës Profesionale dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimin [Evidencë 28, Neni 45, fq. 33–35].</p> <p>Në rregulloren mësimore [Evidencë 28, Neni 45, fq. 33–35] dhe në çdo syllabus [Syllabuse] jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • provimi i parë (400 pikë të mundshme), • detyrat e kursit (100 pikë të mundshme), • provimi përfundimtar (500 pikë të mundshme). <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:</p>																																
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<table border="1" data-bbox="651 981 1449 1843"> <thead> <tr> <th>Përshkrimi</th> <th>Sistemi i vlerësimit (Nota)</th> <th>Përqindja</th> <th>Pikët</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A (Shkëlqyeshëm- performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)</td> <td>10</td> <td>94-100%</td> <td>935-1000</td> </tr> <tr> <td>B (Shumë mirë- në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)</td> <td>9</td> <td>85-93%</td> <td>845-934</td> </tr> <tr> <td>C+ (Mirë- mbi standartin mesatar por me disa gabime)</td> <td>8</td> <td>76-84%</td> <td>755-844</td> </tr> <tr> <td>C (Mesatar- në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)</td> <td>7</td> <td>67-75%</td> <td>665-754</td> </tr> <tr> <td>D (I kënaqshëm- i drejtë por me mangësi të dukshme)</td> <td>6</td> <td>58-66%</td> <td>575-664</td> </tr> <tr> <td>E (Mjaftueshëm- performanca u përmbahet kriterëve minimale)</td> <td>5</td> <td>51-57%</td> <td>505-574</td> </tr> <tr> <td>FX (Ngel- kërkohet më shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)</td> <td>4</td> <td>≤50%</td> <td>0-504</td> </tr> </tbody> </table>	Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Përqindja	Pikët	A (Shkëlqyeshëm- performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)	10	94-100%	935-1000	B (Shumë mirë- në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)	9	85-93%	845-934	C+ (Mirë- mbi standartin mesatar por me disa gabime)	8	76-84%	755-844	C (Mesatar- në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)	7	67-75%	665-754	D (I kënaqshëm- i drejtë por me mangësi të dukshme)	6	58-66%	575-664	E (Mjaftueshëm- performanca u përmbahet kriterëve minimale)	5	51-57%	505-574	FX (Ngel- kërkohet më shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)	4	≤50%	0-504
Përshkrimi	Sistemi i vlerësimit (Nota)	Përqindja	Pikët																														
A (Shkëlqyeshëm- performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)	10	94-100%	935-1000																														
B (Shumë mirë- në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)	9	85-93%	845-934																														
C+ (Mirë- mbi standartin mesatar por me disa gabime)	8	76-84%	755-844																														
C (Mesatar- në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)	7	67-75%	665-754																														
D (I kënaqshëm- i drejtë por me mangësi të dukshme)	6	58-66%	575-664																														
E (Mjaftueshëm- performanca u përmbahet kriterëve minimale)	5	51-57%	505-574																														
FX (Ngel- kërkohet më shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)	4	≤50%	0-504																														
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>																																	
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson</p>	<p>DSID kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes</p>																																




format e metodat e mësimit në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 58], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësues [Evidencë 140].			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	DSID vendos në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve infrastrukturën e nevojshme teknologjike për përdorimin e metodave inovative të mësimit me qëllim realizimin e objektivave formues të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës [Evidencë 63, Evidencë 91]. Përfshirja e studentëve, nën mbikqyrjen e pedagogëve të lëndëve, në rindërtimin e situatave reale në laborator përmes pajisjeve laboratorike në dispozicion, i aftëson në profesion dhe inkurajon sensin e tyre të autonomisë.			
Konkluzione	<i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Vlerësimi përfundimtar është kombinim i tre vlerësimeve [Evidencë 28, Neni 45, fq. 33 – 35; Syllabuse]: <ul style="list-style-type: none"> • provimi i parë (400 pikë të mundshme), • detyrat e kursit (100 pikë të mundshme), • provimi përfundimtar (500 pikë të mundshme). Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë, të cilat konvertohen në vlerësim me notë sipas përcaktimeve në Standardin III.2, Kriteri 1.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UAMD vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. UAMD që nga viti 2018 është pjesë e projektit CleanScore 2016-2018 të Albanian American Development Foundation.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës, në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të UAMD dhe syllabuset e lëndëve, është kombinim i tre vlerësimeve [Evidencë 28, Neni 45, fq. 33 – 35; Syllabuse]:</p> <ul style="list-style-type: none"> • provimi i parë (400 pikë të mundshme), • detyrat e kursit (100 pikë të mundshme), • provimi përfundimtar (500 pikë të mundshme). <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë, të cilat konvertohen në vlerësim me notë sipas përcaktimeve në Standardin III.2, Kriteri 1.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në orën pasardhëse të mësimin personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura [Evidencë 28, Neni 39, fq. 28-29].</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren mësimore [Evidencë 28, Neni 40, fq. 29-30]:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës. 2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi. 3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit. <p>Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës. Gjithashtu, procesverbalit i bashkëngjitet provimi, i cili vlerësohet me 0 pikë.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Brenda 72 orëve nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar, personeli akademik i lëndës dorëzon pranë sekretarisë mësimore procesverbalin e rezultateve, si dhe tezat e korrigjuara së bashku me tezat origjinale në një zarf të mbyllur. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme [Evidencë 28, Neni 39, fq. 28-29].</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të</p>





<p>studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Njësisë Kryesore ku bën pjesë studenti, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i FSP ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të grupit mësimor. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet [Evidencë 28, Neni 41, fq. 30].</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>DSID në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimit. Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të parë <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe menaxhim Detar” ka për mision [Evidencë 28, Neni 6, fq. 4-5]:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. T'u ofrojë studentëve mundësinë që të marrin dhe zhvillojnë dijet, si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e navigimit për drejtimin e anijeve, si dhe të menaxhimit portual e të mjeteve detare; 2. Të nxisë tek studentët të menduarit dhe analizuarit kritik për të kuptuar sfidat në situata të ndryshme të navigimit detar; 3. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë teknike dhe logjistike në fushën e mjeteve detare (anijeve) dhe të transportit detar.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit,</p>	<p>Natyra e kompetencave të kërkuara në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit duke qenë se sektori detar është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Gjatë orëve të fundit të mësimit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara [Syllabuse].
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuaru kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Kurrikula e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” [Evidencë 47] është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e detarisë. Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre. Bashkëpunimet e DSID në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kontribuojnë në rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere [Evidencë 31, Evidencë 56.1, Evidencë 64, Evidencë 65]. <i>GVJ, nisur nga DVV dhe takimet në Institucion, konstaton që në këtë program studimi nuk ka patur studentë të diplomuar me temë diplome, angazhim i cili mundëson përfshirjen e tyre në kërkim shkencor.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	DSID zhvillon vazhdimisht leksione të hapura me stafin e tij akademik dhe me staf të ftuar duke sjell tek studentët zhvillimet më të fundit në fushën e detarisë dhe menaxhimit detar, brenda dhe jashtë vendit [Evidencë 80].
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike</i>

	<p>në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e detarisë. GVJ konstaton se pjesëmarrja e studentëve në kërkim shkencor është në nivele të ulta.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi [Evidencë 28, Neni 43, fq. 31-32; Evidencë 80].</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti/Grupi mësimor kërkimor-shkencor “Menaxhimi i Transportit dhe Detarisë” përcakton listën e temave të diplomave dhe programet e lëndëve bazë për provimin e përgjithshëm përfundimtar të formimit në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik [Evidencë 28, Neni 43, fq. 31-32]. Studentët, pasi njihen me programin e provimit të formimit, asistohen nga koordinatori dhe mentorët e programit të studimit, si dhe pedagogët e lëndëve me informacione, udhëzime dhe materiale në funksion të mbarëvajtjes së tij.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në provimin përfundimtar të mbrojtjes së diplomës përfshihen lëndët karakterizuese të programit përkatës, pra, të gjitha lëndët e veprimtarisë B. Mund të përfshihen lëndë të kategorisë C në ato raste kur janë të profilit profesional të programit. Pesha që zë secila prej lëndëve në përmbajtjen e tezës së provimit, përcaktohet mbi bazën e krediteve të lëndëve. Komisioni harton një tabelë me pikët përkatëse që do të ketë secila lëndë në vlerësimin e përgjithshëm prej 1000 pikësh sipas peshës në kredite të secilës lëndë [Evidencë 80].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e</p>	<p>FSP ka hartuar një procedurë për përzgjedhjen e temës së diplomës nga ana e studentëve [Evidencë 82], por nisur nga <i>RVB</i> dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton që nuk ka patur studentë që kanë përmblyllur studimet me temë diplome.</p>

<p>temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi i formimit vlerësohet me notë. Secila lëndë ka peshën e saj mbi bazën e krediteve përkatëse në vlerësimin e përgjithshëm prej 1000 pikësh [Evidencë 80].</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë "Bachelor" në "Navigacion dhe Menaxhim Detar" në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>FSP ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Navigacion dhe Menaxhim Detar" përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi.</i></p> <p><i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë "Bachelor" në "Navigacion dhe Menaxhim Detar" në Fakultetin e Studimeve</i></p>




	<p><i>Profesionale, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i></p> <p><i>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se në këtë program studimi nuk ka patur studentë të diplomuar me temë diplome.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X





**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, gjatë tre viteve akademike janë angazhur në mësimdhënie [Tabela 4] staf akademik si më poshtë:</p> <p>Gjatë vitit akademik 2020 – 2021 9 PAE janë angazhuar: (3 Prof. Asoc. Dr., 1 Dr., 5 MSc.), 10 PAK (1 Prof. Dr., 1 Dr., 8 MSc.);</p> <p>Gjatë vitit akademik 2021 – 2022, janë angazhuar 9 PAE (3 Prof. Asoc. Dr., 1 Dr., 5 MSc.), 10 PAK (1 Prof. Dr., 1 Dr., 8 MSc.);</p> <p>Gjatë vitit akademik 2022 – 2023, janë angazhuar 9 PAE (2 Prof. Asoc. Dr., 1 Dr., 6 MSc.), 9 PAK (1 Prof. Dr., 1 Dr., 7 MSc);</p> <p>Niveli i kualifikimit dhe fusha kërkimore – shkencore e personelit akademik të angazhuar, është në përputhje me specifikat e këtij programi studimi, dhe lëndëve të zhvilluara nga ta [Evidencë 24].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa mësimore e mbuluar nga personeli akademik efektiv, për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <p>për vitin akademik 2020 – 2021, është 53.0%;</p> <p>për vitin akademik 2021 – 2022, 53.0%;</p> <p>për vitin akademik 2022 – 2023, 53.4%;[Tabela 4].</p> <p>Nga sa më sipër rezulton që për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”.</p> <p><u>GVJ rekomandon</u> që përballimi i ngarkesës mësimore të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e</p>	<p>Institucioni lidh kontrata të punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kontratë në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, në të cilat parashikohet mbulimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore [Evidencë 86].</p> <p>Nga të dhënat e vëna në dispozicion në DVV vihet re një qëndrueshmëri e stafit ndër vite [Tabela 4]</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit, të mbështetur në kriteret të përgjithshme, në përputhje me kërkesat ligjore, dhe kriteret specifike sipas nevojave të Departamenteve dhe programeve të studimit që ofron [Evidencë 87], duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	DSID garanton angazhimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik [Evidencë 22] për realizimin korrekt të orëve laboratorike të parashikuara në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, si dhe mirëmbajtjen e ambienteve dhe pajisjeve laboratorike përkatëse.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UAMD përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron. Sektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për ruajtjen e këtij informacioni, i cili vihet në dispozicion të njësive kryesore dhe bazë të Institucionit sipas nevojave të tyre.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim	Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë




<p>me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>aktivitetin e tyre në drejtim të navigacionit dhe menaxhimit detar, si: Autoriteti Portual Durrës [Evidencë 33], Drejtoria e Përgjithshme Detare [Evidencë 34], kompania Adria Ferries [Evidencë 35] etj. Këto institucione vënë në dispozicion të studentëve personel të kualifikuar për mbikëqyrjen e praktikës profesionale, i cili mbështet studentët në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre [Evidencë 32, Evidencë 37].</p>			
<p>Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në programin e studimit Bachelor në "Navigacion dhe Menaxhim Detar" është angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë dhe personel ndihmës akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi, nevojat dhe specifikat e programit.</i></p> <p><i>Institucioni ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit.</i></p> <p><i>Bashkëpunimi me ente të ndryshme, të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në fushën e navigacionit dhe menaxhimit detar mundëson realizimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve.</i></p> <p><i>GVJ konstaton, që ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik efektiv gjatë tre viteve të fundit akademike, nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi (ngarkesa PAE duhet të jetë mbi 70%). Konkretisht, rezulton për vitin akademik 2020 – 2021, 53.0%, për vitin akademik 2021 – 2022, 53.0% dhe për vitin akademik 2022 – 2023, 53.4%.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	FSP ka në dispozicion ambjente në godinën e UAMD në Currila dhe në Kampusin 1, auditorë dhe laboratorë, ambjente për stafin akademik, për studentët etj., të cilat plotësojnë nevojat për mbarëvajtjen e programeve të studimit të ofruara nga ky fakultet dhe specifikisht për programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” [Evidencë 88].
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Auditorët dhe laboratorët e FSP janë të pajisur me mjete të teknologjisë së informacionit, stenda dhe projektorë, smartboard etj. duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies [Evidencë 63, Evidencë 91].
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	DSID ka në dispozicion të tij laboratorë me pajisjet e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” [Evidencë 92]. Institucioni ka hartuar edhe rregullore për mbarëvajtjen e veprimtarive në laboratorët e tij [Evidencë 90].
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	FSP ka lidhur marrëveshje me Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit pranë UAMD [Evidencë 93], duke mundësuar përdorimin e laboratoreve të teknologjisë së informacionit të këtij fakulteti për studentët e programeve të studimit të FSP dhe konkretisht të studentëve të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”.
Konkluzione	<i>FSP ka në dispozicion ambjente me pajisjet e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore të programit të studimit Bachelor në</i>




	"Navigacion dhe Menaxhim Detar", duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në bibliotekën mësimore të FSP vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Navigacion dhe Menaxhim Detar", në format fizik dhe elektronik pa pagesë [Evidencë 98, Tabela 17, Evidencë 100], literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje me syllabuset e lëndëve, të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve [Evidencë 52, Evidencë 53].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik janë platformat dhe libraritë <i>online</i> [Tabela 17]: <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi KOHA; - Sistemi COBISS; - Akses në U-Library (EBSCO); - Akses në jstor.com; - Akses pa limit në UNPAYWALL.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	DSID kujdeset në përditësimin e syllabuseve të lëndëve [Evidencë 96] në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe literaturën bashkëkohore në fushën e studimit dhe raportimin e tyre pranë Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka mësimore e FSP dhe fondi i literaturës në dispozicion të saj garantojnë shfrytëzimin në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Navigacion dhe Menaxhim Detar" [Evidencë 97, Evidencë 98].

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e UAMD është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UAMD punon dhe është e hapur cdo ditë jave për studentat me orare të vazhduara edhe gjatë fundjavës në përgjigje të nevojave të studentëve [Evidencë 101].</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>UAMD ka hartuar dhe zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues [Evidencë 102], në përputhje me nevojat e programeve të studimit, si dhe analizon vazhdimisht shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe atij <i>online</i> nga personeli akademik dhe studentët duke marrë masa në funksion të saj.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në bibliotekën mësimore të FSP vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit Bachelor në "Navigacion dhe Menaxhim Detar", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje me syllabuset e lëndëve, të cilat garantojnë marrjen e njohurive të</i></p>




	<i>parashikuara në programin e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UAMD disponon platformën ESSE3 e ofruar nga RASH [Evidencë 105]. Sistemi është një platformë, e cila krijon mundësinë e personalizimit sipas nevojave dhe specifikave të institucionit. UAMD disponon bazën e të dhënave, që përmban informacion mbi studentët të tilla, si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e regjistrimit në universitet, datë çrregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), datën e diplomimit etj. Këtë bazë të dhënash e plotësojnë, përditësojnë dhe e disponojnë sekretaritet mësimore të secilit Fakultet dhe Sektori i IT dhe e vënë në dispozicion të organeve drejtuese me kërkesë të tyre.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UAMD përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit administrojnë të dhënat jo vetëm për studentët e tij, por edhe për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Personeli dhe studentët e UAMD përmes sistemit të menaxhimit kanë akses të dedikuar në informacione dhe dokumente [Evidencë 108, Evidencë 109].
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe	Në funksion të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit studentët dhe pedagogët përdorin edhe platforma të tjera komunikimi elektronik.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.									
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UAMD disponon një faqe web në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin, informacion mbi organizimin akademik dhe administrativ, informacion mbi fakultetet, ciklet e studimit, programet e studimit dhe stafin akademik për çdo njësi, informacion mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, programet e shkëmbimeve studentore Erasmus+, aktivitetet e ndryshme dhe të shumta që zhvillohen në UAMD përgjatë gjithë vitit, si dhe shërbimet e ofruara për studentët [uamd.edu.al/].								
Konkluzione	<i>UAMD disponon platformën ESSE3 e ofruar nga RASH, përmes të cilës administrojnë të dhënat e studentëve, stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.</i> <i>UAMD disponon një faqe web-i në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UAMD harton raporte financiare, që përmbajnë një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera. Në detajimin e përdorimit të të ardhurave të pritshme për periudhën Janar – Dhjetor 2021 për UAMD [Evidencë 114], paraqiten të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 (Gjithsej 34,729,304 ALL) dhe të ardhurat e pritshme për t'u arkëtuar gjatë vitit 2021 (Gjithsej 210,435,000 ALL) për një total 245,164,304 ALL, të cilat janë parashikuar të përdoren në masën 99,9%, sipas zërave mëposhtë: A. Të ardhurat që do të përdoren për shpenzime për personel akademik të ftuar – 6.1%;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>B. Të ardhurat për detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për stafin me kohë të pjesshme – 0.0%;</p> <p>C. Të ardhurat për të financuar shpenzimet operative - 21.8%;</p> <p>D. Të ardhurat për të rimbursuar studentët – 2.0%;</p> <p>E. Të ardhurat për investime – 70.0%.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shërbimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, aksesin në bibliotekat <i>online</i> dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij [Evidencë 115, Evidencë 116].</p> <p>Në hartimin e projekt buxhetit për vitin akademik 2021 – 2022, të hartuar nga Dekani [Evidencë 115] dhe përcjellë rektorit, janë paraqitur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasqyra 1: Parashikimi i numrit të studentëve si të ardhurat e pritshme për periudhën 2021 – 2022; - Pasqyra 2: Tregues të performancës; - Pasqyra 3: Numri i punonjësve për v. a. 2021 – 2022; - Pasqyra 4: Mallra dhe shërbime të tjera v. a. 2021 – 2022; - Pasqyra 5: Planifikimi i kërkesave për investime v.a. 2021 – 2022; - Pasqyra 6: Planifikimi i kërkesave për kërkimin shkencor v.a. 2021 – 2022.
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UAMD i nënshtrohet çdo vit një auditimi të brendshëm, të kryer nga njësi e auditimit të brendshëm dhe të drejtuar nga Bordi i Administrimit. Në këtë kuadër, UAMD ka hartuar një rregullore “Karta e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, UAMD” mbi bazën e së cilës rregullon zhvillimin e këtij procesi brenda tij [Evidencë 117].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV [Evidencë 115, Evidencë 116], GVJ vlerëson se Institucioni raporton mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës deri në njësinë kryesore dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të</p>	<p>Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV dhe takimet në Institucion, GVJ vlerëson se Institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen.</p>

përmirësimin të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>UAMD dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV [Evidencë 19, Evidencë 20, Evidencë 28] dhe takimet në Institucion me studentë të këtij programi studimi, vlerëson se Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundur ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në këtë kuadër, UAMD ka hartuar edhe një rregullore specifike “Për trajtimin e studentëve me aftësi të kufizuara në UAMD” për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve këtyre studentëve [Evidencë 121].
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Çdo departament përcakton për të gjitha programet e studimit që ofron, kuotat dhe kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues, të cilat miratohen nga Senati Akademik i UAMD brenda datës 20 dhjetor [Evidencë 20, Neni 44, fq. 24; Evidencë 120]. Kanë të drejtë të kandidojnë për pranim në studimet e ciklit të parë [Evidencë 20, Neni 44, fq. 24]: a. kandidatët që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM; b. kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj; c. shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëse dhe shumëpalëse.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë	Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, janë të shprehura qartë në rregulloren e Departamentit [Evidencë 27, Neni 42, fq. 23, Neni 46, fq. 26, Neni 48, fq. 27] dhe të programit të studimit [Evidencë 28, Neni 22–24, Neni 26, fq. 14–19] dhe publikohen në faqen elektronike të Fakultetit.




lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Studentët mund informohen për vijueshmërinë e studimeve të tyre dhe rezultatet e provimeve përmes aksesimit të faqeve të tyre personale në sekretarinë <i>online</i> Pitagora.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Gjatë muajit Janar, përpara fillimit të vitit akademik, publikohen në faqen elektronike të Fakultetit kuotat dhe kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni ka hartuar një rregullore për krijimin e kushteve të përshtatshme në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentët me aftësi të veçanta në programet e studimit që ofron [Evidencë 121].
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni parashikon kuota për studentët e huaj në programet e studimit që ofron bazuar në njohjen e studimeve të tyre para universitare (shkolla e mesme) në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi [Evidencë 20, Neni 44, pika 6.c, fq. 24]. Përzgjedhja e studentëve bëhet mbi të njëjtat kriteret të vlefshme edhe për kandidatët vendas [Evidencë 120].
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Bazuar në VKM Nr. 386, datë 01.06.2022, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në Institucionet publike të Arsimit të Lartë”, programi i studimit <i>Bachelor</i> në “ <i>Navigacion dhe Menaxhim Detar</i> ” është fushë prioritare dhe studentët e përfshirë në të përfitojnë mbështetje financiare.
Konkluzione	<i>Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë, vendas dhe të huaj, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit, që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, janë të shprehura qartë në aktet rregullatore të Institucionit. Institucioni ka hartuar një rregullore për krijimin e kushteve të përshtatshme në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentët me aftësi të veçanta në programet e studimit që ofron. Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “<i>Navigacion dhe Menaxhim Detar</i>” është fushë prioritare dhe studentët e përfshirë në të përfitojnë mbështetje financiare.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatoren e programit të studimit dhe përgjegjësën e grupit të tyre mësimor mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik [Evidencë 28].
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rastet e transferimit të studimeve, dosja e kandidatit shqyrtohet nga një komision <i>ad hoc</i> i ngritur me urdhër të dekanit, në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 28, Neni 26, fq. 19].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Gjatë javës së parë të mësimin, në fillim të vitit akademik [Evidencë 123], studentët njihen me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 28]. dhe syllabuset e lëndëve [Syllabuse], ku ndër të tjera janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi [Evidencë 28, Neni 43, fq. 31-32; Evidencë 80].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të, stafin akademik dhe infrastrukturën mësimore në dispozicion të programeve të studimit, përmes vizitave në shkollat e mesme, pjesëmarrjes në panaiet “Work and study” të organizuara nga Dhoma e tregtisë në bashkëpunim me MAS, si dhe duke ftuar maturantët në ambjentet e Universitetit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Konkluzione	<p><i>Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen gjatë javës orientuese dhe në seancat e para të leksioneve me kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik, me procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit dhe informacione të tjera të rëndësishme për mbarëvatjen e studimeve të tyre.</i></p> <p><i>Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatorin e programit të studimit dhe përgjegjës të grupit të tyre mësimor mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit [Evidencë 28]. Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve [Syllabuse].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në kuadër të praktikës profesionale, DSID vë në dispozicion të studentëve Udhëzuesin e Praktikës Profesionale [Evidencë 37].
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni përmes Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës dhe Departamentit informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm (CV, letër motivimi, letër rekomandimi etj.) përmes aktiviteteve këshilluese të organizuara në mënyrë periodike [Evidencë 124, Evidencë 125, Evidencë 126].
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ nisur nga vizitat në Institucion me studentë të këtij programi studimi, vlerëson se Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambjentet e Universitetit dhe në faqen e saj <i>online</i> , të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të	Studentët e UAMD përmes sistemit të menaxhimit kanë akses të dedikuar <i>online</i> në informacione dhe dokumente [Evidencë 108, Evidencë 109].

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.							
Konkluzione	<i>Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet dhe orienton përmes aktiviteteve këshilluese të organizuara në mënyrë periodike.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Kjo mundëson realizimin nga ana e personave të autorizuar të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve [Të dhëna studentët; Tabela 23].
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, në vitin akademik 2019 – 2020, janë regjistruar 25 studentë (çregjistruar 1 studentë), në vitin akademik 2020 – 2021, janë regjistruar 34 studentë (çregjistruar 1 studentë), në vitin akademik 2021 – 2022, janë regjistruar 25 studentë (çregjistruar 2 studentë) [Të dhëna studentët]. Në vitin akademik 2019 – 2020 janë diplomuar 30 studentë, nga të cilët 20 (67%) janë të punësuar në përputhje me profilin e studimit, në vitin akademik 2020 – 2021 janë diplomuar 29 studentë, nga të cilët 18 (62%) janë të punësuar në përputhje me profilin e studimit, në vitin akademik 2021 – 2022 janë diplomuar 21 studentë, nga të cilët 14 (67%) janë të punësuar në përputhje me profilin e studimit [Tabela 23].
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	




<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>FSP kontrollon periodikisht sekretarinë mësimore, si njësia përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të studentëve mbi saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët. Dekani kontrollon veprimtarinë e sekretarisë përmes komisioneve <i>ad hoc</i>, të cilat verifikojnë saktësinë e të dhënave të shënuara në dokumentat e diplomës për studentët e diplomuar [Evidencë 128].</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni harton raporte me të dhëna analitike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe mbi cilësinë e punësimit të tyre përmes Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës [Raporti Vjetor DSID, Evidencë 131, Evidencë 132], duke i shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të tyre.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni disponon Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ndjek dhe ruan të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Studentët e UAMD kanë përfaqësimin e tyre, sipas parashikimeve në statutin e Institucionit [Evidencë 19, neni 14, pika 6 – 7; neni 90; Evidencë 133], në senatin akademik, pjesë e të cilit janë dy përfaqësues të studentëve të përzgjedhur prej tyre në përputhje me rregulloren e zgjedhjeve, dhe këshillat e studentëve. Institucioni mbështet dhe nxit pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Përfaqësuesit e studentëve janë pjesë e GVB duke sjellë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>mendimin e tyre në hartimin e RVB, si dhe duke dhënë kontributin e tyre në procesin e vlerësimit të Institucionit.</p>		
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>FSP dhe DSID garantojnë përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 58], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e programit të studimit [Evidencë 134]. Të dhënat e marra përmes këtyre instrumentave, analizohen duke u bërë pjesë e diskutimeve në Departament dhe më gjerë. <i>GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizitat në Institucion me stafin akademik dhe studentët, nuk ka evidentuar ndonjë rast konkret të kontributit të studentëve në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit Bachelor në "Navigacion dhe Menaxhim Detar".</i></p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. Ankesa I drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë45nnovative45u bën pjesë student, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve [Evidencë 28, Neni 41, fq. 30]. Institucioni ndjek procedurat e parashikuara në rregullore për zgjidhjen e problematikës.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD mbështet dhe nxit pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>			
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>		
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme</p>	<p>Pranë UAMD funksionon Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Ky sektor është struktura përgjegjëse, që zhvillon dhe drejton</p>		




<p>në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë [Evidencë 124, Evidencë 125, Evidencë 126].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një46nnovam të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentët njihen me mundësitë për punësim nga Departamenti dhe Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është në dispozicion të studentëve me këshilla dhe orientime për hartimin e CV-së, letrës së motivimit për aplikime të mundshme46nnoavaa dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Departamenti në bashkëpunim me Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është në kontakt të vazhdueshëm me ente të ndryshme për të mundësuar praktikat profesionale, të cilat janë edhe një urë drejt punësimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ndjek punësimin e studentëve të diplomuar. Në vitin akademik 2019 – 2020 janë diplomuar 30 studentë, nga të cilët 20 (67%) janë të punësuar në përputhje me profilin e studimit, në vitin akademik 2020 – 2021 janë diplomuar 29 studentë, nga të cilët 18 (62%) janë të punësuar në përputhje me profilin e studimit, në vitin akademik 2021 – 2022 janë diplomuar 21 studentë, nga të cilët 14 (67%) janë të punësuar në përputhje me profilin e studimit [Tabela 23].</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Pranë UAMD funksionon Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës si strukturë përgjegjëse, që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në UAMD funksionon Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila është e përbërë nga dy sektorë: Sektori i Çështjeve Mësimore dhe Sektori i Kurrikulës dhe Vlerësimit të Cilësisë [Evidencë 141, Evidencë 70]. Këto struktura promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike [Evidencë 69].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	DSID monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 58], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 140].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Rezultatet e pyetësorit analizohen dhe bëhen diskutim në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në senat, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve, duke evidentuar praktikën e mira dhe duke hartuar një plan masash për zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e procesit mësimor aty ku është e nevojshme.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e pyetësorëve i transmetohen DSID, i cili bën analizën përkatëse dhe në bashkëpunim me NjSBC bëhet adresimi i problematikave të evidentuara. Rezultatet e pyetësorit bëhen publike, përveç vlerësimeve individuale të pedagogëve, të cilat ju bëhen me dije dhe diskutohen individualisht në rastet kur rezultojnë problematika.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	DSID merr në analizë gjithë problematikën që lidhet me procesin mësimor dhe aktivitetin kërkimor [Raporti Vjetor DSID]. Informacioni i marrë nga pyetësori i studentëve, formulari i vetëvlerësimit të personelit akademik, kontrolleve të ushtruara etj. janë objekt i një analize të thelluar që synon vlerësimin e rezultateve të marra, promovimin e praktikave të mira, si dhe nxitjes dhe inkurajimit të personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.




Konkluzione	<p>Në UAMD funksionon Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila është e përbërë nga dy sektorë: Sektori i Çështjeve Mësimore dhe Sektori i Kurrikulës dhe Vlerësimit të Cilësisë, të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. DSID monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në nivel Institucional, strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë [Evidencë 70]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik; - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC); - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL); - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC), e cila është e përbërë nga dy sektorë: Sektori i Çështjeve Mësimore dhe Sektori i Kurrikulës dhe Vlerësimit të Cilësisë [Evidencë 141]; <p>Në nivel Fakulteti, përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti) - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.) - Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.) <p>UAMD, përmes këtyre strukturave, synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë tij, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë [Evidencë 70].</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Pranë FSP është ngritur NJSBC në nivel fakulteti [Evidencë 70, Neni 9, fq. 11-12], e cila nxit dhe mbështet punën në kuadër të sigurimit të cilësisë të stafit drejtues, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, studentëve të programit të studimit, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>NjsBC mbledh të dhënat statistikore dhe përcakton treguesit kyç të performancës për të analizuar kontributin e tyre ndaj arritjes së objektivave strategjike institucionale [Evidencë 70, Pjesa V, fq. 17-19]. UAMD i është nënshtruar akreditimit të jashtëm institucional dhe është vlerësuar pozitivisht me një akreditim 4 vjeçar të vlefshëm deri në muajin Mars 2026. Institucioni gjithashtu, kujdeset dhe ndjek akreditimin e programeve të tij të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>NjsBC përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjsBC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve. Të dhënat kryesore statistikore përfshijnë, por nuk kufizohen [Evidencë 70, Neni 15, fq. 17-18]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit; - mundësitë e punësimit të të diplomuarve; - profilin e popullatës studentore; - raportin pedagog/studentë; - plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre; - efektivitetin e pedagogëve; - koston e burimeve të mësimnxënies dhe disponueshmërinë e tyre; - monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve; - nivelin e largimit/transferimit të studentëve; - numrin i stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen; - treguesit kyç të performancës së institucionit dhe elementë të ngjashëm.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia përgjegjëse në UAMD për sigurimin e cilësisë është Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila është e përbërë nga dy sektorë: Sektori i Çështjeve Mësimore dhe Sektori i Kurrikulës dhe Vlerësimit të Cilësisë. Pranë FSP është ngritur NJSBC në nivel fakulteti. NjsBC mbledh të dhënat statistikore dhe përcakton treguesit</i></p>




	<i>kyç të performancës për të analizuar kontributin e tyre ndaj arritjes së objektivave strategjike institucionale.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre [Evidencë 140]. Rezultatet e pyetësorëve analizohen nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.</p> <p>Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij.</p> <p>Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse, dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave.</p> <p>Institucioni organizon gjithashtu, mbledhje të hapura në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke nxitur tek ata ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të</p>	<p>FSP dhe DSID përdorin metoda të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit:</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të drejtëpërdrejta, përmes kontakteve të koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit me studentët [Evidencë 58]; - të tërthorta, përmes pyetësorëve drejtuar studentëve për vlerësimin e programit të studimit [Evidencë 134]. <p>Informacionet e mbledhura nga këto instrumenta bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në Senat, me praninë e përfaqësuesve të studentëve, duke promovuar praktikën e mira dhe duke propozuar një plan masash për problematikat e evidentuara, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave të programeve të studimit të ofruara, përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përmirësimin e formave të vlerësimit të studentëve, etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike cilësinë e programit të studimit me metoda të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta përmes Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, si njësi përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, FSP dhe DSID.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, Institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Detyrat dhe përgjegjësitë e njësive dhe individëve përgjegjës për SBC të programeve të studimit janë të përcaktuara në rregulloren e saj [Evidencë 70].</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e SBSC. KPGSC, në rolin e një komisioni të përhershëm, kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC. Kjo e fundit, ka si funksion kryesor bashkëpunimin dhe asistimin e këtij Komisioni. KPGSC mbikqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. DKSC mund të përcjellë sipas rastit, apo pas kërkesës së KPGSC dokumentacione apo informacione të ndryshme që zotërohen nga Drejtoria. 2. NjBSC në nivel Fakulteti, realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC në nivel Institucional. Në realizimin e këtyre objektiveve NjBSC në nivel Fakulteti kërkon dosjen e programeve të studimit nga koordinatorët e programeve. Në realizimin e objektiveve të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional.		
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Pranë FSP është ngritur NjBSC në nivel fakulteti [Evidencë 70, Neni 9, fq. 11-12], e cila nxit dhe mbështet punën në kuadër të sigurimit të cilësisë të stafit drejtues, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, studentëve të programit të studimit, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt tyre. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm me të cilët UAMD ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të navigacionit dhe menaxhimit detar, si: Autoriteti Portual Durrës [Evidencë 33], Drejtoria e Përgjithshme Detare [Evidencë 34], kompania Adria Ferries [Evidencë 35] etj. Institucioni është në kontakt të vazhdueshëm me ta për studimin e tregut të punës, për përmirësimin e kurrikulave, për shkëmbimin e stafit, zhvillimin e praktikave mësimore etj.		
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.			
Konkluzione	<i>FSP, DSID, personeli akademik, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të Institucionit përfshihen dhe informohen në mënyrë të vazhduar mbi procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Institucion është transparent me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC. Në faqen e tij web institucioni ka një faqe të dedikuar për SC (https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/), në të cilën publikohen informacione të ndryshme mbi këtë proces, të aksesueshme për të gjithë. GVJ gjatë vizitës, konkludoi se studentët dhe stafi kishin informacion të konsiderueshëm lidhur me veprimtaritë e Institucionit në funksion të SBC.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij.</p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse [Evidencë 140], dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Analizat periodike [Evidencë 140; Evidencë 132; Evidencë 131] dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë mundësojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion me stafin akademik dhe studentët u informua se Institucioni organizon mbledhje të hapura, në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke i informuar ata dhe duke nxitur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucion është transparent me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC duke krijuar një kulturë të cilësisë brenda Institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni kujdeset në përditësimin e vazhduar të programit të studimit, në përputhje me nevojat e tregut të punës, kurrikulave analoge të vendeve anëtare të BE, kërkesat e IMO, EMSA dhe STCW-78/95 dhe zhvillimet më të fundit të fushës.
2. Institucioni angazhon në mësimdhënie staf akademik të kualifikuar, me eksperiencë të gjatë akademike dhe profesionale.
3. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione vendase dhe të huaja, përmes të cilave mundëson shkëmbimin e stafit dhe studentëve, ndarjen e eksperiencave dhe zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në përputhje me nevojat e programit të studimit.
4. Institucioni në funksion të këtij programi studimi disponon laboratorë me pajisje bashkëkohore për zhvillimin e aftësive të studentëve në përputhje me nevojat konkrete të tregut e punës.

Pika të dobta:

1. Institucioni nuk harton raporte analitike të mirëfillta të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar (Standardi I.2 – Kriteri 4).
2. Pjesëmarrja e studentëve në kërkim shkencor është në nivele të ulta. Në këtë program studimi nuk ka patur studentë të diplomuar me temë diplome (Standardi III.4 – III.5).
3. Ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik efektiv gjatë tre viteve të fundit akademike, nuk është në masën mbi 70%, në përputhje me legjislacionin në fuqi (Standardi IV.1 – Kriteri 2).

Rekomandime:

1. Institucioni të hartojë raporte analitike të mirëfillta të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar.
2. Institucioni të nxisë studentët, të cilët plotësojnë detyrimin e notës mesatare të mbyllin studimet e tyre me temë diplome dhe të angazhohen në kërkim shkencor.
3. Institucioni të marrë masa për të mbuluar mbi 70% të ngarkesës nga personel akademik efektiv, në përputhje me legjislacionin në fuqi.




Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Navigation and Maritime Management" provided by the Higher Education Institution University "Aleksandër Moisiu", Durrës

Strengths and affirmations

1. The Institution takes care to continuously update the program of study, in accordance with the needs of the labor market, the similiar curricula of EU member countries, the requirements of IMO, EMSA and STCW-78/95 and the latest developments in the field.
2. The Institution engages in teaching qualified academic staff with long academic and professional experience.
3. The Institution has cooperation agreements with national and international institutions, through which it enables the exchange of staff and students, the sharing of experiences and the development of professional practices of students in accordance with the needs of the program of study.
4. The institution in function of this program of study has laboratories with modern equipment for the development of students' skills in accordance with the concrete needs of the labor market.

Weaknesses

1. The institution does not prepare analytical reports on the benefits from cooperation agreements, clearly specifying the benefits for each program of study offered. [(Standard I.2 – Criter 4)].
2. Student participation in scientific research is at low levels. In this program of study, there were no students graduated with a diploma thesis. [(Standard III.4 – III.5)]
3. The academic load covered by effective academic personnel during the last three academic years is not more than 70%, in accordance with the legislation in force. [Standard IV.1 – Criter 2)].

Recommendation

1. The Institution should prepare analytical reports on the benefits from cooperation agreements, clearly specifying the benefits for each program of study offered.
2. The Institution should encourage students, who meet the average grade requirement to complete their studies with diploma thesis and engage in scientific research.
3. The Institution should take measures to cover over 70% of the academic load with effective academic personnel, in accordance with the legislation in force.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X